REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI POLITEKNIK, TIRANË
FAKULTETI I INXHINIERISË MATEMATIKE DHE INXHINIERISË FIZIKE
DEPARTAMENTI I INXHINIERISË MATEMATIKE

DISERTACION

PËR MARRJEN E GRADËS SHKENCORE
DOKTOR

TITULLI

Përafrime numerike të zgjidhjeve të problemeve jolineare stokastike të reaksion difuzionit me zhurmë të bardhë ose me zhurmë reale në hapësira të Sobolevit

Paraqitur nga:

M.Sc. Sofije Hoxha

Udhëheqës shkencor:

Prof. Dr.Fejzi Kolaneci

Tiranë, 2022

UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
FAKULTETI I INXHINIERISE MATEMATIKE DHE INXHINIERISE FIZIKE
DEPARTAMENTI I INXHINIERISE MATEMATIKE

Disertacion
I
Paraqitur nga

M.Sc. Sofije Hoxha

Për marrjen e gradës shkencore

DOKTOR

Programi i studimit : Analizë Numerike dhe Ekuacione Diferenciale

Tema : Përafrime numerike të zgjidhjeve të problemeve jolineare stokastike të reaksion difuzionit me zhurmë të bardhë ose me zhurmë reale në hapësira të Sobolevit

Udhëheqës Shkencor: Prof. Dr. Fejzi Kolaneci

Mbrohet më dt 27. 04. 2022. para jurisë:

1. Prof. Dr. Shkëlqim KUKA	**Kryetar**
2. Prof. Dr. Lulëzim HANELLI	**Anëtar (oponent)**
3. Prof. As. Eglantina KALLUCI	**Anëtar (oponent)**
4. Prof. Dr. Luela PRIFTI	**Anëtar**
5. Prof. Dr. Shpëtim LEKA	**Anëtar**

PARATHËNIE

FALENDERIME

Falenderimet kryesore shkojnë për Fakultetin e Inxhinierisë Matematike dhe Inxhinierisë Fizike si dhe Departamentin e Inxhinierisë Matematike, për mbështetjen dhe ndihmën e vazhdueshme në realizimin e studimit të doktoratës.

Dua të falenderoj udhëheqësin tim shkencor, Prof. Dr.Fejzi Kolaneci për mbështetjen e tij të pakursyer për realizimin e këtij punimi.

Së fundmi, falenderoj familjen time për mbështetjen dhe përkrahjen e vazhdueshme që më kanë dhënë gjatë gjithë kësaj kohe.

PËRMBLEDHJE

Në këtë studim në fillim do të shqyrtohen probleme jolineare stokastike të reaksion-difuzionit në hapësirë-kohë, me zhurmë të bardhë ose me zhurmë reale. Do të studjohet dhe do të vërtetohen teorema përkatëse për ekzistencën dhe unicitetin e zgjidhjes së problemeve që do të shtrohen në hapësira të Sobolevit. Më tej, do të analizohen përafrime numerike të zgjidhjeve duke përdorur metoda të ndryshme, për ekuacionet me terma jolineare Lipshisiane dhe jo-Lipshisiane.

Objektiv kryesor do të jetë vërtetimi i konvergjencës probabilitare uniforme në lidhje me variablin e kohës t, të zgjidhjeve të përafërta tek zgjidhjet e sakta të problemeve që shqyrtohen. Vëmendje e veçantë i kushtohet metodës Galerkin, skemave implicite, përafrimeve sipas normës Holder dhe metodës me diferenca të fundme Godunov-Rabjenkin. Gjithashtu, do të studiohen përafrime numerike të zgjidhjeve për problemet jolineare stokastike të Shredingerit dhe të Boussinesq-Gloverit. Rezultatet teorike të përfituara do të zbatohen në disa probleme konkrete të shkencave teknike dhe biomjekësore.

Abstract

In this study we will first study nonlinear stochastic reaction-diffusion problems with white space-time or real-time noise. The existence and uniqueness of Sobolev's problem-solving space will be proven. Numerical approximations of the solution will then be analyzed using different methods and nonlinear Lipshician and non-Lipshician terms will be examined.

The main goal is to prove the probabilistic convergence of approximate solutions to the correct solution of the problem under consideration, uniformly with respect to the time variable. Particular attention will be paid to the Galerkin method, implicit schemes, approximations to the Holder norm, and the Godunov-Rabjenkin method with finite differences. Numerical approximations of the solutions of Schrodinger and Boussinesq-Glover nonlinear stochastic problems will also be studied. Approximate theoretical results will be applied to concrete problems of technical sciences and biomedicine.

Përmbajtja e lëndës

Hyrje	1
KAPITULLI 1	
Ekzistenca dhe uniciteti i zgjidhjeve stacionare për ekuacionet e reaksion difuzionit jolineare të rastit në hapësirat Banah	3
1.1 Ekuacioni i zhurmës	4
1.2. Ekuacioni evolucionar i rastit me operatorë monotonë	6
1.2.1 Pranimet	6
1.2.2 Një vlerësim paraprak	8
1.3. Ekzistenca e zgjidhjeve stacionare	12
1.3.1 Përkufizimi i zgjidhjeve stacionare	12
1.3.2 Rezultati kryesor	13
1.3.3 Shuma e operatorëve monotonë	17
1.4 Zbatime të ekuacioneve të reaksion-difuzionit jolineare të rastit me zhurmë reale	18
KAPITULLI 2	
Ekzistenca dhe uniciteti i zgjidhjeve për ekuacionet dy-dimensionale stokastike lineare të Businesk	
2.1 Hyrje	20
2.2 Hapësirat funksionale dhe formulimi i problemit	20
2.3 Ekzistenca dhe uniciteti i zgjidhjeve	22
KAPITULLI 3	26
Uniciteti sipas trajektoreve dhe konvergjenca e zgjidhjeve të përafërta për një model stokastik të rritjes së tumorit me zhurmë të ngjyrosur	30
3.1 Hyrje	30
3.2 Uniciteti sipas trajektoreve	31
3.3 Konvergjenca e zgjidhjeve të përafërta probabilitare	33
3.4 Zbatime	34
3.4.1 Ritmi i përhapjes së qelizave tumorale të ndjeshme ndaj ilaceve	34
3.4.2 Termi i zhurmës	35
3.4.3 Zhurma e qelizave të ndjeshme të tumorit të asgjësura për shkak të ilaçeve kundër kancerit	36
3.4.4 Trajektoria e termit të zhurmës	36

KAPITULLI 4	
Atraktorët e rastit për ekuacionet gjysmëlineare stokastike të reaksion difuzionit me zhurmë reale në hapësirat e Hilbertit	38
4.1 Bashkësitë thithëse dhe atraktorët	38
4.2 Bashkësitë thithëse në hapësirën Hilbert H	41
PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME	43
BIBLIOGRAFIA	45

HYRJE

Teoria e ekuacioneve jo-lineare të reaksion –difuzionit të rastit është një nga objektet e rëndësishme që është studjuar nga shumë autorë në shtete të ndryshme të botës. Në punimin tonë, së pari studjohet një problem jo-linear i reaksion-difuzionit në hapësirën Banah, të drejtuar nga një zhurmë reale, me koeficient të difuzionit të rastit dhe kushte fillestare të rastit. Ky problem i përket klasës së ekuacioneve diferenciale të pjesshme stokastike parabolike. Supozohet se kushti fillestar është një element i hapësirës Hilbert. Zhurma reale është një proces Wiener. Fillimisht konsiderohet një bazë e përshtatshme stokastike dhe jepet kuptimi i zgjidhjes së dobët të problemit të reaksion-difuzion. Më tej përkufizohet kuptimi i zgjidhjes së fortë Doob-Rozanov për procesin stokastik stacionar. Funksioni i shpërndarjes probabilitare të procesit stokastik është i pavarur nga koha t. Jepet kuptimi i masës invariante (të pandryshueshme) për ekuacionin e rastit të reaksion-difuzionit në kuptimin e Arnold, DaPrato dhe Zabczyk, [2, 5]. Me fjalë të tjera, përkufizohet masa stacionare për sistemin dinamik të rastit, të shoqëruar me problemin e rastit të reaksion-difuzionit.

Duke zbatuar Teorinë e Mosbarazive Variacionale, vërtetohen vetitë e zgjidhjes stacionare për problemin jo-linear të reaksion-difuzionit të rastit. Rezultatet teorike të fituara mund të jenë të dobishme në zbatime të ndryshme në Fizikën Kuantike, Biologji, Mjekësi dhe Shkencat Ekonomike, [3, 4, 6, 7, 8, 18, etj.]. Në studimin tonë tregohet ekzistenca e zgjidhjes stacionare për një model stokastik që modelon rritjen tumorale. Zgjidhja stacionare është shumë e dobishme në mjekësi për diagnozimin dhe përcaktimin e terapive klinike për shumë sëmundje kanceroze, [6, 7, 8, 10, 13, 19, 31, 32, etj.]

Në vazhdim të studimit shqyrtohet problemi stokastik i Boussinesq në zonat e ngopura të tokës. Rrjedhja e ujit në mjediset e ngopura të tokës përshkruhet dhe modelohet nga ekuacioni dydimensional i Boussinesq. Një pjesë e punimit i kushtohet studimit të problemit stokastik të Boussinesq në prani të rastësisë në përcjellshmërinë hidraulike, porozitetin e kullueshëm, ringarkimin, avullimin, kushtin fillestar dhe atë kufitar. Problemi është shqyrtuar në hapësirat Sobolev dhe metoda e zgjidhjes së tij është e tipit Galerkin.

Duke u bazuar në disa supozime të arsyeshme, vërtetohen ekzistenca dhe uniciteti i zgjidhjes së problemit stokastik linear të Boussinesq, si dhe korrektësia e shtrimit të problemit që konsiston në vërtetimin e vazhdueshmërisë së zgjidhjes së tij nga të dhënat fillestare, të supozuara këto të vazhdueshme.

Me tej studjohet një model i cili përbën një ekuacion diferencial stokastik me derivate të pjesshme në hapësirën tre dimensionale, me një term zhurmë. Një model stokastik konkret është zhvilluar për të përshkruar rritjen e një tumori për regjimin e qelizave të shpërndara (pa formuar akoma një masë tumorale).

Karakteristika kryesore e këtij modeli është se ai merr parasysh sjelljen e pavarur të qelizave të tumorit, si dhe bashkëveprimet e rastësishme ndërmjet qelizave tumorale, qelizave të sistemit imunitar dhe ilaçeve antikanceroze. Vërtetohet uniciteti i zgjidhjes dhe një rezultat për konvergjencën e saj. Sugjerohen disa zbatime biomjekësore të rezultateve matematike të përftuara.

Kapitulli 1

Ekzistenca dhe uniciteti i zgjidhjeve stacionare të ekuacioneve jolineare të rastit të reaksion difuzionit në hapësirat Banah.

Në këtë kapitull do të studjohen ekuacionet jolineare të rastit të reaksion difuzionit. Këto ekuacione përbëjnë një klasë të rëndësishme në teorinë e ekuacioneve me derivate të pjesshme të rastit. Së pari janë të rëndësishme për vetë matematikën që gjenerojnë. Së dyti për zbatimet e tyre dhe lidhjet me disa fusha: fizikën, kiminë, biologjinë, mjekësinë, atronominë dhe shkencat ekonomike. Kanë pasur dhe do të vazhdojnë të kenë një ndikim të madh në këto fusha.

Për të qënë më specifikë do të konsiderojmë një ekuacion të reaksion difuzion të rastit me polinome jolineare në hapësirën Banah. Sigurisht mund të shqyrtohen modele më të përgjithshme, për shembull, ekuacionet e rastit Lotka - Volterra, ekuacionet e rastit Boussinesq - Glover, ekuacionet e rastit të mbi-rrjedhshmerisë, ekuacionet e rastit Belousov-Zhabotinsky me zbatime në kiminë dinamike, etj.

Le të jetë $(\Omega, \mathrm{F}, (\mathrm{F_t})_{\mathrm{t}\geq 0}, P)$ një bazë stokastike dhe le të jetë

$$w(t) = (w_1(t), w_2(t), \dots \dots, w_m(t))$$

Një proces standart m-dimensional Wiener *i* përcaktuar në $(\Omega, \mathrm{F}, (\mathrm{F_t})_{\mathrm{t}\geq 0}, P)$. Për këtë bazë stokastike le të jetë $\widehat{\xi(t)}$ një zgjidhje stacionare e ekuacionit Ito në R^k

$$d\xi(t) = a\xi(t)dt + b\xi(t)dw(t), \qquad t \geq 0, \tag{1.1}$$

kur $\mathrm{a}(\cdot)$ dhe $\mathrm{b}(\cdot)$ kënaqin kushtet e përmendura më sipër. Studjohet procesi $(\Omega, \mathrm{F}, (\mathrm{F_t})_{\mathrm{t}\geq 0}, P, (\xi(\mathrm{t}))_{\mathrm{t}\geq 0})$ si një model me zhurmë reale, e cila nuk ndryshon me kalimin e kohës, pra nuk është në varësi të kohës. Pranohet se procesi i zhurmës reale është i dhënë me ekuacionin (1.1) dhe shqyrtohet ekuacioni jolinear i rastit në hapësirat e Hilbertit:

$$\frac{du(t,\omega)}{dt} + A\left(\hat{\xi}(t,\omega), u(t,\omega)\right) = f\left(\hat{\xi}(t,\omega)\right), \quad t \geq 0, \ \omega \in \Omega, \tag{1.2}$$

Në rastin kur $\{A(\xi,\cdot), \xi \in R^k\}$ është një familje operatorësh monotonë në një treshe Gelfand $V \subset H \subset V'$, dhe f është një funksion i R^k tek V', studimi ynë ka për qëllim që të vërtetojë ekzistencën një zgjidhjeje stacionare të ekuacionit (1.2). Vihet re se ky ekuacion nuk ka në përmbajtje të tij ekuacione diferenciale Ito.

Në vitet e fundit, [5, 9, 21, 22, 23, etj.] ka patur shumë publikime mbi masat invariante dhe zgjidhjet stacionare për ekuacionet e tipit Ito në hapësirat e Hilbertit. Në këto studime rasti i zhurmës reale nuk trajtohet. Në krahasim me literaturën ekzistuese, që ne kemi studjuar dhe përdorur, përmendim dy aspekte origjinale të studimit tonë.

Së pari, ne konsiderojmë zhurmën reale $\hat{\xi}(t)$ si një proces të caktuar Markov, që nuk ndryshon me kalimin e kohës. Në përputhje me këtë proces ξ (t), gjejmë një zgjidhje të ekuacionit (1.2). Ky fakt motivon disa detaje teknike të analizës së mëposhtme, si p.sh. zgjedhja e një baze të veçantë stokastike. Këto përbëjnë rezultate të reja në lidhje me literaturën e publikuar me ekuacionet e Ito.

Së dyti, nuk do të supozojmë ndonjë kompaktësi, pra do të konsiderojmë vetëm rastet kur kompaktësia nuk ekziston. Nga përvoja jonë e studimit, të gjitha metodat e njohura në literaturë, për të provuar ekzistencën e masave invariante ose zgjidhjeve stacionare, përdorin lloje të ndryshme kompaktësish, që burojnë nga topologjitë e hapësirave funksionale të përfshira. Dihet se struktura e monotonisë lejon të provohet ekzistenca e zgjidhjeve pa ndonjë supozim të kompaktësisë. Sidoqoftë, nuk ka rezultate të ngjajshme për ekzistencën e masave invariante dhe zgjidhjeve stacionare, pa supozuar apo përdorur argumente të kompaktësisë.

Në fund të këtij punimi paraqiten disa zbatime të cilat motivojnë analizën tonë.

Kuptime fillestare

1.1 Ekuacioni i zhurmës

Shënojmë me $L(R^m, R^k)$ hapësirën e operatorëve lineare të R^m në R^k dhe me $|\cdot|_{L_2(R^m,R^k)}$ normën e operatorëve lineare Hilbert-Schimdt të R^m në R^k.

Supozohen kushtet e mëposhtme:

(a.1) Format $a(\cdot): R^m \to R^k$ dhe $b(\cdot): R^k \to L(R^m, R^k)$ janë të vazhdueshme në kuptimin Lipchitz dhe egzistojnë konstantet $\eta\ dhe\ \rho$, për të cilat kënaqet mosbarazimi

$$2\langle a(x), x\rangle_{R^k} + b(x)^2_{L^2(R^m,R^k)} \le -\eta|x|^2_{R^k} + \rho, \quad \forall x \in R^k$$

(a.2) $\eta > 0$ (konstantja η në mosbarazimin e mësipërm është pozitive),

Shqyrtojmë ekuacionin diferencial stokastik

$$d\xi(t) = a\big(\xi(t)\big)dt + b\big(\xi(t)\big)dw(t), \quad t \geq 0, \tag{1.3}$$

me kusht fillestar

$$\xi(0) = \xi_0 \tag{1.4}$$

Vërtetohen pohimet e mëposhtme :

(i) Nën supozimin (a.1), për çdo $p \geq 2$ dhe për çdo $\xi_0 \in L^p(\Omega, \mathrm{F}_0, P, R^k)$, problemi (1.3)-(1.4) ka një zgjidhje të vetme, të matshme në mënyrë progresive $\xi(t)$, të përcaktuar për $t \geq 0$ me $\xi(t) \in L^p(\Omega, \mathrm{C}[0,\mathrm{T}], R^k))$, për çdo T>0

Kjo zgjidhje është një proces Markov me vetinë Feller

(ii) Në qoftë se përveç kësaj, (a.2) është i vërtetë, atëherë ekziston një masë probabilitare m_0 për ekuacionin (1.3).

Këto rezultate gjenden tek [9] dhe [14]. Ne do të ndjekim hapat bazë të vërtetimit për qëllime instruktive dhe referimi të mëtejshëm.

Le të fillojmë me (i). Pranimet e koeficientëve Lipschitz sjellin ekzistencën dhe unicitetin e zgjidhjes maksimale. Zgjidhja është globale, dhe kënaq kushtin $\xi(t) \in L^p(\Omega, \mathrm{C}[0,\mathrm{T}], R^k))$.

Nga formula Ito dhe a.1), kemi:

$$d|\xi(t)|_{R^k}^p \leq \Big(2\langle a\big(\xi(t)\big), \xi(t)\rangle_{R^k} + \big|b\big(\xi(t)\big)\big|_{L^2(\mathrm{R}^m, R^k)}^2\Big) \cdot |\xi(t)|_{R^k}^{p-2} \cdot dt$$

$$+2|\xi(t)|_{R^k}^{p-2} \cdot \langle b\big(\xi(t)\big)dw(t), \xi(t)\rangle_{R^k} \leq -\eta|\xi(t)|_{R^k}^p \cdot dt + \rho \cdot |\xi(t)|_{R^k}^{p-2} \cdot dt$$

$$+2|\xi(t)|_{R^k}^{p-2} \cdot \langle b\big(\xi(t)\big)dw(t), \xi(t)\rangle_{R^k} \leq -\eta|\xi(t)|_{R^k}^p \cdot dt + C_0(p)dt$$

$$+2|\xi(t)|_{R^k}^{p-2} \cdot \langle b\big(\xi(t)\big)dw(t), \xi(t)\rangle_{R^k},$$

me konstatnte $C_0(p)$ që nxirret nga mosbarazimi Young.

Supozohet se $\xi_0 \in L^p(\Omega, \mathrm{F}_0, P, R^k)$.

Rezulton se

$$E|\xi(t)|_{R^k}^p \leq e^{\frac{-\eta t}{2}} \cdot E|\xi_0|_{R^k}^p + \int_0^t e^{\frac{-\eta(t-s)}{2}} C_0(p) \cdot ds, \qquad t \geq 0 \tag{1.5}$$

Në fakt, duke qenë se kemi të bëjmë me një zgjidhje lokale të përcaktuar apriori në një interval kohor të rastit, duhet të bëjmë herë pas here, (e thënë ndryshe çdo herë pas një numri fiks hapash), një vlerësim për pritjen e supremmumit në kohë të $|\xi(t)|_{R^k}^p$, ky i fundit duke përdorur mosbarazimet klasike martingale. Detajet mund të gjenden në [9]. Këto vlerësime apriori japin ekzistencën globale të zgjidhjes dhe integrueshmërinë e saj. Karakteristikat për proceset Markov dhe Feller janë klasike.

Vertetësia e (ii) gjithashtu vijon nga (1.5), nën supozimin (a.2). Në të vërtetë, në qoftë se zgjedhim $\xi_0 = 0$, atëherë (1.5) dhe (a.2) sjellin që për çdo p≥ 2 ekziston një konstante $C(p) > 0$, e tillë që

$$|\xi(t)|_{R^k}^p \leq C(p), \quad \forall t \geq 0 \tag{1.6}$$

Kjo nënkupton ekzistencën e një mase invariante m_0, me metodën standarde Bogoliubov - Krylov, për çdo p≥ 2,

$$\int_{R^k} |x|^p \cdot dm_0(x) \leq C(p) \tag{1.7}$$

Kjo verteton (ii).

Janë studjuar vetitë e masave invariante për ekuacionin (1.3). Për shembull, ka vënd vetia e mëposhtme:

Në qoftë se matrica $b(\xi)b^*(\xi)$ është pozitivisht e përcaktuar në mënyrë uniforme për $\xi \in R^k$, atëherë masa invariante është e vetme.

1.2. Ekuacioni evolucionar i rastit me operatorë monotonë

1.2.1 Pranimet

Le të jetë H një hapësirë separable reale dhe $V \subset H$ është një hapësirë refleksive separable Banah (norma $|\cdot|, \|\cdot\|$ respektive, produkti skalar $\langle \cdot, \cdot \rangle$ në H, V kompakte në H, dhe $V \subset\to H$. Le të jenë H' dhe V' hapësirat duale të tyre. Identifikojmë H me dualin H', dhe H'me një nënhapësirë të V'. Mund të shkruajmë

$V \subset H \subset V'$. Shkruajmë gjithashtu çiftimin e dyfishtë midis V′ dhe V me $\langle \cdot, \cdot \rangle$, pasi kufizimi i tij në $V \times H$ përkon me produktin e brendshëm të H. Pasi kemi përcaktuar këto supozime dhe dualet e secilës hapesirë, bëhen pranimet e mëposhtme:

Le të jetë $\{A(\xi,\cdot), \xi \in R^k\}$ një familje e operatorëve lineare nga V' e cila kënaq supozimet e mëposhtme :

(A.1) për çdo $u \in V$, $\xi \to A(\xi, u)$ është fortësisht e matshme nga R^k tek V'.

(A.2) për çdo $\xi \in R^k$ $u, v, z \in V$, funksioni

$$s \to \langle A(\xi, v + sz), u\rangle$$

është i vazhdueshëm në R.

(A.3) Ekziston një konstante $\lambda_0 \in R$ e tillë që për çdo $\in R^k$, $u, v \in V$

$$2\langle A(\xi, u) - A(\xi, v), u - v\rangle + \lambda_0 |u - v|^2 \geq 0,$$

(A.4) Ekziston një funksion $\rho: R^k \to [0, \infty)$ dhe konstantet $p \geq 2$, $\lambda \in R$, $\alpha > 0$, $r \geq 0, C_\rho > 0$, të tilla që për çdo $\xi \in R^k$, $u \in V$,

$$2\langle A(\xi, u), u\rangle + \lambda |u|^2 \rho(\xi) \geq \alpha \|u\|^p, \text{ dhe } \quad \rho(\xi) \leq C_\rho (1 + |\xi|_{R^k}^r)$$

(A.5) Me P si më lart, ekziston konstantja $C_A > 0$, e tillë që për çdo $\xi \in R^k$, $u \in V$,

$$\|A(\xi, u)\|_{V'} \leq C_A (1 + \|u\|^{p-1})$$

Përfundimisht, le të jetë $f = f(\xi): R^k \to V'$ një funksion i dhënë i cili është fortësisht i matshëm që kënaq supozimet **(f.1):** Ekziston konstantia $C_f > 0$, e tillë që për të gjitha $\xi \in R^k$:

(f1) $$\|f(\xi)\|_{V'}^{p'} \leq C_f (1 + |\xi|_{R^k}^r)$$

kur p' është eksponenti i konjuguar i p (d.m.th $\frac{1}{p} + \frac{1}{p'} = 1$)

Verejtje 1.1. Në disa raste është e natyrshme të supozohet se proceset e zhurmës që hyjnë në A dhe f janë të ndryshme; por kjo mund të arrihet vetëm duke e konsideruar si $\xi(t)$ procesin e zhurmës së përbashkët.

Le të jetë $(\Omega, F, (F_t)_{t \geq 0}, P)$ hapësirë probabilitare e plotë, e cila jepet me një proces standard m-dimensional w(t).

$$w(t) = \big(w_1(t), w_2(t), \dots\dots, w_m(t)\big), \qquad t \geq 0,$$

nënsupozimin (a.1) jepet $\xi_0 \in L^r(\Omega, \mathrm{F}_0, P, R^k)$. Le të jetë $\xi = \xi(t,\omega)$ një zgjidhje koresponduese të problemit (3) - (4). Atëherë r është e njëjtë me kushtet (A.4).
Shqyrtohet ekuacioni evolucionar i rastit si më poshtë:

$$\frac{du(t,\omega)}{dt} + A(\xi(t,\omega), \quad \mathrm{u}(t,\omega)) = f\big(\xi(t,\omega)\big), t \geq 0, \ \omega \in \Omega, \tag{1.8}$$

me kusht fillestar

$$u(0,\omega) = u_0(w), \qquad \omega \in \Omega \tag{1.9}$$

Supozohet se

$$u_0 \in L^2(\Omega, \mathrm{F}_0, P, H) \tag{1.10}$$

Problemi (1.8) –(1.10) interpretohet në kuptimin e zgjidhjes së dobët:

$$\langle u(t,\omega), \phi\rangle + \int_0^1 \langle A\big(\xi(s,\omega), \mathrm{u}(s,\omega)\big), \phi\rangle \cdot ds = \langle u_0(\omega), \phi\rangle + \int_0^1 \langle f\big(\xi(s,\omega)\big), \phi\rangle \cdot ds,$$
$$\forall t \geq 0, \forall \phi \in V \tag{1.11}$$

Nga zgjidhja e ekuacioneve (1.8) – (1.9), kemi të bëjmë me një proces progresivisht të matshëm $u = u(t,\omega)$, për $t \geq 0$.
Kemi faktin e mëposhtëm:

(iii) Nën supozimin (a.1) të paragrafit 2.1, jepet $\xi_0 \in L^p(\Omega, \mathrm{F}_0, P, R^k))$, jepet zgjidhja koresponduese $\xi(t,\omega)$ e ekuacioneve (1.3) – (1.4), dhe nën supozimet (A.1) – (A.5), (f.1), ekziston një zgjidhje e vetme e problemit (1.8) – (1.9).

Duke zbatuar metodën Galerkin, për çdo $\omega \in \Omega$, gjendet zgjidhja e vetme $u(t,\omega)$ e ekuacionit (1.11), shiko [12]

1.2.2 Një vlerësim paraprak

Le të jetë $A_n(\xi,\cdot)$ një operator në H_n. Përkufizohet

$$A_n(\xi,u) = P_n\big(A_n(\xi,u)\big), \quad u \in H_n, \ \ \xi \in R^k$$

dhe le të jetë

$$f_n(\xi) = P_n\big(f_n(\xi)\big), \quad \xi \in R^k$$

Atëherë, le të jetë $\{u_{0n}\}_{n\in N}$ kushti fillestar, $\forall n,$

$$u_{0n} \in L^2(\Omega, \mathrm{F}_0, P, H_n) \text{ dhe}$$

$$u_{0n} \to u_0 \text{ në } H.$$

Jepet

$$\xi_0 \in L^r(\Omega, \mathrm{F}_0, P, R^k) \tag{1.13}$$

Le të konsiderojmë një zgjidhje Galerkin për ekuacionin (1.8) të shoqëruar me ekuacionin (1.3):

$$\frac{du_n(t,\omega)}{dt} + A_n\big(\xi(t,\omega), u_n(t,\omega)\big) = f_n\big(\xi(t,\omega)\big), t \geq 0, \ \ \omega \in \Omega \tag{1.14}$$

$$d\xi(t) = a\big(\xi(t)\big)dt + b\big(\xi(t)\big)dw(t)\,, \quad t \geq 0 \tag{1.15}$$

me kushte fillestare

$$u_n(0,\omega) = u_{0n}(w), \quad \xi(0,\omega) = \xi_0(\omega) \tag{1.16}$$

Le të jetë $\beta > 0$ që kënaq inekuacionin e mëposhtëm:

$$|v|^2 \leq \beta \|v\|^2, \quad \forall v \in V$$

Lemma 1.1 Shqyrtohet sistemi (1.14)-(1.15)-(1.16) nën hipotezat (a.1), (A.1)-(A.5), (f.1), (1.13) dhe ekziston një konstante C$>$ 0, që varet nga n, e tillë që

$$E(|u_{0n}|^2) \leq C, \forall n \in N \tag{1.17}$$

Atëherë kemi këto përfundime

(i) Sistemi (1.14)-(1.15)-(1.16) ka një zgjidhje të vetme në $H_n \times R^k$.

(ii) Për çdo $\varepsilon > 0$ ekziston një konstante $C(\varepsilon) > 0$ e tillë që

$$|u_n(t,\omega)|^2 \leq e^{\gamma t}|u_{0n}(\omega)|^2 +$$

$$+ \int_0^1 e^{\gamma(t-s)} \cdot [a - \varepsilon + (C_f C(\varepsilon) + C_\rho)(1 + |\xi(s)|^r_{R^k})] \cdot ds \tag{1.18}$$

për të gjitha $n \in N\,, t > 0\,,\ P - a.e.\omega \in \Omega$

ku $\overbrace{\gamma = \lambda}^{d} - \frac{\alpha-\varepsilon}{\beta}$.

(iii) për çdo T> 0 ekzistojnë konstantet $C_1(T), \dots.., C_4(T)$, të tilla që plotësojnë këto kushte

$$E\left(\sup_{t\in[0,T]} |u_n(t,\omega)|^2\right) \leq C_1(T), \quad \forall n \in N \tag{1.19}$$

$$E\int_0^T \|u_n(t,\omega)\|^P dt \leq C_2(T)\,, \quad \forall n \in N \tag{1.20}$$

$$E\int_0^T \|A_n(\xi_n(t,\omega), u_n(t,\omega)\|_{V'}{}^P dt \leq C_3(T), \quad \forall n \in N \tag{1.21}$$

$$E\int_0^T \|u'_n(t,\omega)\|_{V'}{}^P dt \leq C_4(T), \quad \forall n \in N \tag{1.22}$$

Vërtetim

Pjesa e parë (i).

Në fillim, ekuacioni (1.15) është konsideruar i pavarur, me kushte fillestare ξ_0, dhe me zgjidhje të vetme të vazhdueshme dhe progresivisht të matshme**,** $\xi(t)$. Atëherë, mund të marrim $\omega \in \Omega$ (P-a.s), dhe kjo vlerë zbatohet për ekuacionin (1.14) me kushte fillestare u_{0n} (ky i fundit tashmë është një problem determinist). Rezultatet e [1] japin një zgjidhje të vetme

$$u_n(t,\omega) \in C([0,T], H_n).$$

Matshmëria progresive e $u_n(t,\omega)$ deduktohet lehtësisht nga ndërtimi i $u_n(t,\omega)$ si një limit i përafrimeve të tipit Peano të matshëm në mënyrë progresive. Vërtetimet e vetive Markov dhe Feller janë klasike.

Pjesa e dytë (ii).

Nga ekuacioni (1.14) kemi

$$\frac{d|u_n(t)|^2}{dt} + 2\langle A_n\big(\xi(t), u_n(t)\big), u_n(t)\rangle = 2\langle f_n\big(\xi(t)\big), u_n(t)\rangle \tag{1.23}$$

Atëherë, nga supozimet kemi këtë përfundim

$$\frac{d|u_n(t)|^2}{dt} + \alpha\|u_n(t)\|^p \leq \lambda|u_n(t)|^2 + \rho\big(\xi(t)\big) + 2\big\|f_n\big(\xi(t)\big)\big\|_{V'} \cdot \|u_n(t)\|$$

Përdorim gjithashtu supozimin (f.1), për çdo $\varepsilon > 0$ dhe kemi :

$$\frac{d|u_n(t)|^2}{dt} + (\alpha - \varepsilon)\|u_n(t)\|^p$$

$$\leq \lambda|u_n(t)|^2 + C(\varepsilon)\big\|f_n\big(\xi(t)\big)\big\|^{P'}{}_{V'} \cdot \|u_n(t)\| + \rho\big(\xi(t)\big)$$

$$\leq \lambda|u_n(t)|^2 + \big(C_f C(\varepsilon) + C_\rho\big)\big(1 + |\xi(s)|^r_{R^k}\big) \qquad (1.24)$$

Atëherë, $C(\varepsilon) = \frac{1}{P' \varepsilon^{\frac{p}{p'}}}$ nxirret nga mosbarazimi i Young. Rimarim përkufizimin β, supozojmë p≥ 2, dhe përdorim faktin qe $x^p \geq x^2 - 1$ për $x \geq 0$, kemi:

$$\frac{d|u_n(t)|^2}{dt} \leq \left(\lambda - \frac{\alpha-\varepsilon}{\beta}\right)|u_n(t)|^2 + \alpha - \varepsilon + \big(C_f C(\varepsilon) + C_\rho\big) \cdot \big(1 + |\xi(s)|^r_{R^k}\big) \qquad (1.25)$$

Inekuacioni (1.18) pasohet tani nga lema e Growell.

Pjesa e tretë (iii).

Jepet $T > 0$, shënojmë me $C_0(T)$ vlerën më të madhe të $e^{\gamma t}$ mbi $[0, T]$. Nga (1.18) kemi:

$$|u_n(t,\omega)|^2 \leq C_0(T)|u_{0n}(w)|^2 + \int_0^T C_0(T)\big[\alpha - \varepsilon + \big(C_f C(\varepsilon) + C_\rho\big) \cdot \big(1 + |\xi(s)|^r_{R^k}\big)\big] \cdot ds, \quad \forall t \in [0, T] \qquad (1.26)$$

Rimarim (1.5), mbetja jep (1.19)

Kthehemi mbrapa tek inekuacioni (1.24), dhe integrojmë nga $[0, T]$ me $\varepsilon = \frac{\alpha}{2}$

Kemi

$$E\int_0^T \|u_n(t)\|^P dt$$

$$\leq E(|u_{0n}|^2) + E\int_0^T [\lambda|u_n(t)|^2 + C_f \cdot C\left(\frac{\alpha}{2}\right) + C_p) \cdot \big(1 + |\xi(s)|^r_{R^k}\big)]dt$$

Nga (1.17), (1.19), dhe (1.5), nxirret (1.20).

Nga (1.20) dhe supozimi (A.5) nxirret (1.22). Vërtetimi është i kompletuar .

1.3. Ekzistenca e zgjidhjeve stacionare

1.3.1 Përkufizimi i zgjidhjeve stacionare

Prezantojmë tani bazën stokastike të domosdoshme për vazhdim. Le të zgjedhim një masë invariante m_0 për ekuacionin (1.3) me momente të fundme të çdo rendi, ose të paktën me moment të fundëm të rendit r, me r të dhënë nga supozimi (A.4). Kemi treguar në paragrafin më sipër se një masë e tillë ekziston. Le të jetë $(\Omega^0, F^0, (F_t^0)_{t\geq 0}, P^0)$ bazë stokastike e thjeshtë që mbështet (ka suport) procesin stardard m- dimensional Wiener $w(t)$. Le të jenë

$$\Omega = R^k \times [0,1] \times \Omega^0, \quad F = B(R^k) \otimes B(0,1) \otimes F^0,$$

$$\mathrm{F_t} = B(R^k) \otimes B(0,1) \otimes F_t^0 \quad , \quad P = m_0 \otimes \lambda \otimes P^0 \tag{1.27}$$

ku B tregon $\sigma -$algjebrën Borel, dhe λ është e matshme sipas Lebesgue në [0,1]. Konsiderojmë w(t) si një lëvizje Broviane mbi bazën e re stokastike $(\Omega, F, (F_t)_{t\geq 0}, P)$. Me fjalë të tjera,

$$\widehat{w}(t, x, y, \omega^0) = w(t, \omega^0), \quad x \in R^k \quad , \quad y \in [0,1], \quad \omega^0 \in \Omega^0$$

Le të jetë $\widehat{\xi_0} : \Omega \to R^k$ e përkufizuar si

$$\widehat{\xi_0}(x, y, \omega^0) = x, \quad x \in R^k \quad , \ y \in [0,1], \quad \omega^0 \in \Omega^0 \tag{1.28}$$

Atëherë, ligji i $\widehat{\xi_0}$ eshtë $\mathrm{m_0}$. Me supozimin e momentit të r-të të $\mathrm{m_0}$, kemi $\widehat{\xi_0} \in \mathrm{L^r}(\Omega, \mathrm{F_0}, \mathrm{P}, \mathrm{R^k})$. Meqenëse $\mathrm{m_0}$ është një masë invariante, dhe ekuacioni (1.3) përcakton një proces Markov, zgjidhja $\hat{\xi}(\mathrm{t})$ e ekuacionit (1.3) me kushtin fillestar $\widehat{\xi_0}$ është një proces stacionar. Kemi përdorur komponentin $\mathrm{R^k}$ të bazës stokastike për të ndërtuar $\widehat{\xi_0}$ dhe zgjidhjen $\hat{\xi}(\mathrm{t})$. Komponenti [0,1] i bazës stokastike do të përdoret për të ndërtuar kushte fillestare të përshtatshme për përafrimet e Galerkin të ekuacionit monoton (ekuacioni me operatorin monoton). Duke pasur parasysh bazën stokastike dhe procesin stacionar w(t, ω) të përcaktuar, themi se një proces stokastik $\hat{\xi}(t)$) është një zgjidhje e problemit (1.8) - (1.9), në kuptimin e nënparagrafit të mëparshëm, në lidhje me disa kushte fillestare u_0, shiko (1.10), dhe përveç kësaj u është një proces stacionar në H. Kjo do të thotë se për çdo $n \in N$, $0 \le t_1 < t_2 < \cdots < t_n$ dhe $h > 0$, ligji i përbashkët i shpërndarjes së probabiliteteve i

$$(u(t_1 + h), u(t_2 + h), \dots, u(t_n + h) \in H^n$$

është i pavarur nga h.

Vërejtje 1.2. Përkufizimi i dhënë më lart korrespondon me pikëpamjen se zhurma është një proces i caktuar. Pra, në një kuptim, kërkojmë një formë të zgjidhjeve të forta, në vend të zgjidhjeve të dobëta. Sidoqoftë, zgjedhim një bazë të përshtatshme stokastike që nga fillimi, në mënyrë që t'i përgjigjrt zgjidhjes së dobët dhe të fortë, shiko [5], [9].

Një version më i fortë do të kërkonte që procesi i përbashkët $(\hat{\xi}(t), u(t))$ të jetë invariant në $R^k \times H$. Në fakt, kjo është forma e stacionaritetit që do të vërtetojmë.

1.3.2 Rezultati kryesor

Sjellin ndërmend përkufizimin e β të bërë pak më lart

Teorema 1.1

Supozohet se kënaqen kushtet (a.1) dhe (a.2) të formuluara më lart. Në bazën stokastike (1.27) shqyrtohet madhësia e rastiti $\widehat{\xi_0}$ e përkufizuar nga (1.28) dhe zgjidhja e stacionare shoqëruese $\hat{\xi}(t)$ e ekuacionit (1.3).

Supozohet se kënaqen (A.1)-(A.5) dhe (f.1) dhe se $\lambda < \frac{\alpha}{\beta}$. Vërtetohet se ekuacioni (1.8) me kushtin fillestar (1.9), i cili kënaq (1.10), ka një zgjidhje stacionare.

Vërtetim

Hapi 1.

Për çdo numër të dhënë natyror n, shqyrtohet sistemi (1.14) - (1.15) - (1.16) në bazën stokastike (1.27).

Në (1.16) zgjedhim si ndryshore ξ_0, variablin e rastësishëm $\widehat{\xi_0}$ të përcaktuar nga (1.28) dhe $u_{0n} = 0$ për të gjitha n-të.

Në përputhje me këto kushte fillestare, $(u_n(t), \widehat{\xi}(t))$ është zgjidhja e (1.14) - (1.15). Shënojmë me u_t^n ligjin e $(u_n(t), \hat{\xi}(t))$ në $H \times R^k$ dhe me ρ_1^n ligjin mbi $H \times R^k$ të

Përcaktuar nga

$$\rho_1^n = \frac{1}{t}\int_0^t \mu_s^n \, ds$$

Të dyja, μ_t^n dhe ρ_1^n kanë m_0 mbi R^k. Familja $\{\mu_t^n, \ t \geq 0\}$ është e ngjeshur. Për ta vërtetuar këtë, tek (1.18) marrim $\varepsilon > 0$ aq të vogël sa që $\gamma < 0$. Rezultati do të jetë: $E\left|\hat{\xi}(s)\right|_{R^k}^r$ është konstante.

Prandaj:

$$\sup_{t>0} E \int_0^t e^{\gamma(t-s)\cdot(1+\left|\hat{\xi}(s)\right|_{R^k}^r)} \cdot ds < \infty$$

Nga (1.18) gjendet

$$E|u_n(t)|^2 \leq C_1, \ \forall n \in N \ , \ \forall t \geq 0 \qquad (1.29)$$

për një konstante $C_1 > 0$ të pavarur nga n dhe t. (1.29), së bashku me lidhësinë e njëtrajtshme për $E\left|\hat{\xi}(s)\right|_{R^k}^r$, nënkuptojnë nga mosbarazimi Chebishev se familja e masave $\{\mu_t^n \ , t \geq 0\}$ është e ngjeshur. Në fakt, familja $\{\mu_t^n, \ t \geq 0, n \in N\}$ është e ngjeshur, por nuk është e lehtë të përdorësh këtë informacion shtesë për një vërtetim më të drejtpërdrejtë të Teoremës.

Meqenëse kemi vërtetuar se familja $\{\mu_t^n, \ t \geq 0\}$ është e ngjeshur, familja $\{\rho_t^n \ , t \geq 0\}$ është gjithashtu e ngjeshur. Nga teorema Prohorov, e zbatuar për çdo n të dhënë, ekziston një masë probabilitare μ^n në $H \times R^k$ që është limit i dobët i disa vargjeve $\{\rho_{tj}^n\}_{j\in N}$. Tani jemi më të qartë që μ^n ka marxhinal m_0 në R^k.

Me anë të një argumenti klasik (shiko [1]) dhe bazuar në vetitë e Markovit dhe të Feller-it për sistemin (1.13), (1.14) mund të vërtetojmë se μ^n është një masë invariante për këtë sistem. Zbatohet metoda Krylov-Bogoliubov, përveç theksohet se të gjitha masat μ^n kanë të njëjtin m_0.

Më në fund, vërejmë se ekziston një C_2 konstante e pavarur nga n, e tillë që

$$\int_{H\times R^k}(|h|^2 + |x|^2)d\mu^n((h,x) \leq C_2 \ , \quad \forall n \in N \qquad (1.30)$$

Tani mbetet të vërtetohet se ekziston një varg $\{\theta_i(h,x)\}_{i\in N}$ i funksioneve të vazhdueshëm $(h,x) \in H \times R^k$, i cili konvergjon për $i \to \infty$, nga poshtë, në funksionin

$(h,x) \to |h|^2 + |x|^2$ i përcaktuar në $H \times R^k$

Kemi

$$\int_{H\times R^k} \theta_i(h,x)d\mu^n\big((h,x)\big) = \lim_{j\to\infty} \theta_i(h,x)d\rho_{tj}^n\big((h,x)\big) = \frac{1}{t}\int_0^1 E(|u_n(s)|^2)ds$$

$$+ E(\left|\hat{\xi}(s)\right|_{R^k}^2) \le C_2$$

Për një konstante C_2 të pavarur nga n dhe j.

Duke përmbledhur, vërtetohet se ekziston një masë invariante probabilitare μ^n për sistemin (1.14) - (1.15), me margjinal m_0 në R^k, që kënaq mosbarazimin (1.30).

Hapi 2. Zgjidhja stacionare për sistemin përafrues, të përafërt.

Përsëri, shqyrtohet sistemi (1.14) - (1.15) për çdo n të dhënë. Mbi bazën stokastike (1.27) (në fakt, mjafton të përdoret përbërësi $R^k \times [0,1]$ i bazës), për secilën n ekziston një ndryshore e rastit e matshme, e llogaritshme F_0, $\hat{u}_{0,n}$ e tillë që $(\widehat{\xi_0}, \hat{u}_{0,n})$ ka ligj të përbashkët μ^n. Nën supozimet e teoremës marrim $\mu = \mu^n$. Pastaj, supozimet zbatohen për ndryshoret e rastit ψ dhe ϕ, dhe shënojmë ψ me $\hat{u}_{0,n}$ dhe $\phi = (\widehat{\xi_0}, \hat{u}_{0,n})$.

Nga vetia Markov, kujtojmë se zgjidhja $\left(\hat{\xi}(t), \hat{u}_n(t)\right)$ e sistemit (1.14) - (1.15) që korrespondon me kushtin fillestar $(\widehat{\xi_0}, \hat{u}_{0,n})$ është një proces stacionar në $R^k \times H$.

Më në fund nxirret se kemi

$$E\left(\left|\hat{u}_{0,n}\right|^2\right) \le E(|\hat{u}_0|^2) \le C_2\,, \quad \forall n \in N \tag{1.31}$$

Hapi 3. Procedura e kalimit në limit

Le të studiojmë tani konvergjencën e $\hat{u}_n(t)$, *për* $n \to \infty$ dhe $t \in [0, T]$. Le të zbatojmë pjesen (iii) të Lemës 1.1 me kushtet fillestare $(\widehat{\xi_0}, \hat{u}_{0,n})$ të gjetura në hapin e mëparshëm. Ne mund të zbatojmë Lemën 1.1 sepse (1.31) është e vlefshme për këtë rast. Kështu, mosbarazimet (1.19) - (1.22) qëndrojnë të vërteta për $\hat{u}_n(t)$). Prandaj, ekziston një zgjerim $\hat{u}_{n_k}(t)$, tashmë i shënuar nga $\hat{u}_n(t)$, për thjeshtësi të shkruari, i tillë që

$$\hat{u}_n(t) \to \hat{u} \text{ , dobët në } L^P(\Omega \times [0,T]; V)$$

$$\hat{u}_n(t) \to \hat{u} \text{ , dobët } L^2(\Omega; L^\infty(0,T;H))$$

$$A_n(\hat{\xi}, \hat{u}_n) \to A_n(\hat{\xi}, \hat{u}) \text{ , dobët në } L^{P'}(\Omega \times [0,T]; V')$$

$$\frac{d\hat{u}_n(t)}{dt} = \frac{d\hat{u}(t)}{dt} \text{ , dobët në } L^{P'}(\Omega \times [0,T]; V')$$

$$\hat{u}_n(0) \to u_0 \text{ dobët në } L^2(\Omega; H)$$

$$\hat{u}_n(T) \to \hat{u}(T) \text{ dobët në } L^2(\Omega; H)$$

Përdorimi i kushteve (A.2) - (A.4) dhe argumenti klasik i monotonisë, thjeshtuar me faktin se nuk kemi nevojë për formulën e Ito-s, mundësojnë të vërtetohet se

$$\hat{u} \in L^2(\Omega, C([0,T]; H)) \cap L^P(\Omega \times [0,T]; V)$$

duke përdorur argumente klasike dhe të njohura. Vazhdueshmëria e trajektoreve mund të provohet hap pas hapi si më poshtë dhe duke përdorur teknikën përcaktuese si në [9].

Me anë të një procedure diagonale, ndërtimi i radhës së konvergjencës mund të kryhet në mënyrë të tillë që të jete i përshtatshem mbi secilin interval [0, T], në të njëjtin proces të rastit u. Kështu, zgjidhja u e problemit të rastit (1.8), (1.9) vërtetohet për të gjitha $t \geq 0$.

Për të provuar stacionaritetin e zgjidhjes $\hat{u} = \hat{u}(t, \omega)$ na duhet (1.19) dhe pohimi:

$$\hat{u}_n \to \hat{u}^* \text{ dobët në } L^2(\Omega, L^\infty(0,T;H))$$

Nëse përdoren simbolet

$$P_n = \text{ligji } \hat{u}_n \text{ në } L^2(\Omega, L^\infty(0,T;H))$$

$$P = \text{ligji } \hat{u} \text{ në } L^2(\Omega, L^\infty(0,T;H))$$

atëherë (nga Teorema e Prohorov) ekziston një varg n_k , hapësira $\{P_{n_k}\}$ e vargut P_n, e tillë që $P_{n_k} \to P$ për $k \to \infty$.

Vërtetimi është i plotë.

Le të jenë R^k, [0,1] dhe H të pajisura me σ- algebrën Borel, dhe le të jetë m_0 masa e Lebeg në [0,1]. Propozimi tjetër i përdorur më sipër në Hapin 3 merret duke ndryshuar varablet e rastit nga $R^k \times [0,1]$, tek $R^k \times H$. Supozohet të këtë masën e produktit $m_0 \otimes \lambda$ në $R^k \times [0,1]$. Duke pasur parasysh një masë μ mbi $R^k \times H$ gjithmonë gjendet një ndryshore e rastit:

$$\phi \to R^k \times [0,1] \to R^k \times H$$

e tillë që, $\phi(m_0 \otimes \lambda) = \mu$

1.3.3 Shuma e operatorëve monotonë

Është e leverdishme ose e përshtatshme dhe e dobishme të përgjithësohet Teorema 1.1 në rastin e shumës së fundme të operatorëve monotonë. Për çdo i = 1,2,…, υ supozohet se kemi një hapësirë reale refleksive të ndashme Banah $V_i \subset H$ (norma $\|\cdot\|_{i)}$, në H, me identifikimin e zakonshëm.

$$V_i \subset H \subset V_i'$$

Për më tepër, supozohet të kemi një familje të operatorëve jolinearë nga V_i tek V_i' të shënuar me $A_i(\xi,\cdot), \xi \in R^k$, supozime të përshtatshme (A.1) - (A.5) me konstante λ_0, p_i, λ_i, α_i, r_i, C_ρ, C_{A_i}, mundësisht në varësi të i. Së fundmi, supozohet se kemi funksione lehtësisht të llogaritshme, të matshëm,

$$f_i = f_i(\xi): R^k \to V_i'$$

Të cilat kënaqin kushtin (f.1)

Shqyrtohet ekuacioni evolucionar i rastit:

$$\frac{du(t,\omega)}{dt} + \sum_{i=1}^{m} A_i(\hat{\xi}(t,\omega), u(t,\omega)) = \sum_{i=1}^{\upsilon} f_i\left(\hat{\xi}(t,\omega)\right), \quad t \geq 0, \; \omega \in \Omega \qquad (1.32)$$

ku $\hat{\xi}(t,\omega)$ tregon zgjidhjen e ekuacionit (1.1) të përcaktuar në paragrafin 3.1, mbi bazën stokastike (Ω, F, F_t, P) dhënë nga (1.27). Përkufizimi i zgjidhjes stacionare është i njëjtë me atë të dhënë në pjesen e mësipërme. Le të jetë $\beta_i > 0$ një konstante që plotëson mosbarazimet:

$$|x|^2 \leq \beta_i \|x\|_i^2 \ , \quad \forall x \in V_i, \ \ i = 1,2,\dots,\upsilon$$

Teorema 1.2 Supozohet se :

$$\sum_{i=1}^{\upsilon}(\lambda_i - \frac{\alpha_i}{\beta_i}) < 0$$

Atëherë ekuacioni (1.32) ka një zgjidhje stacionare. Vërtetimi është i njëjtë me atë të teoremës se mësipërme.

1.4. Zbatime të ekuacioneve jo lineare të reaksion – difuzionit me zhurmë të bardhë

Në këtë pjesë të studimit ekuacionet e reaksion – difuzionit që do të shqyrtohen janë me polinome jolineare. Termat shtesë të ekuacioneve do të jenë polinome jolineare. Konkretisht do të merret në shqyrtim ekuacioni i formës

$$\frac{\partial u}{\partial t} = c\Delta u - \sum_{h=0}^{2p-1} a_h(x,\xi)u^k \tag{1.33}$$

$x \in D \subset R^3$, $t \geq 0$, $p \in N$, kur D tregon një zonë të hapur të kufizuar në R^3. Kushtet fillestare dhe ato kufitare janë:

$$u(0,x,\omega) = u_0(x,\omega), \tag{1.34}$$

dhe

$$u(t,x,\omega) = 0\ , \quad x \in \partial D \tag{1.35}$$

Supozohet se koeficenti i difuzionit $c = c(\xi)$ është jonegativ, i kufizuar, i matshëm në ξ, dhe i pavaruar nga x.

Supozohet se funksionet e rastit $a_h(x,\xi)$, janë të matshëm në (x,ξ) dhe se ekzistojnë konstantet reale $c_h < C_h$ dhe konstantet pozitive $c_{2p-1} < C_{2p-1}$ të tilla që

$$c_h \leq a_h(x,\xi) \leq C_h, \ \ për \ \ 1 \leq h \leq 2p-1 \ dhe\ për\ cdo\ (x,\xi) \in D \times R^k$$

Në funksionin e rastit $a_0(x,\xi)$ mund të vihen kushtet:

$x \to a_0(x,\xi)$ është i matshëm në ξ, i përket $H^{-1}(D)$, dhe kënaq kushtet :

$$|a_0(x,\xi)|_{H^{-1}(D)} \leq C(1+|\xi|_{R^k}^r)$$

për vlera pozitive të konstante C dhe r. Supozohet se $u_0(x,\omega)$ kënaq kushtin fillestar (1.10)

Falë supozimeve të mëparshme dhe mosbarazimit Young, ekziston konstantia $\bar{c} > 0$ e tillë që

$$(\sum_{h=0}^{2p-1} a_h(x,\xi)u^h)u \geq \frac{1}{2}C_{2p-1}u^{2p} - \bar{c}$$

Le të jetë $H = L^2(D)$, $V = H_0^1(D)$

$$V' = H^{-1}(D), \quad A(\xi,u) = \sum_{h=0}^{2p-1} a_h(x,\xi)u^h, \quad f(\xi) = -a_0\,(x,\xi) \;,$$

Vëretimet e kushteve (A.1)-(A.5) dhe (f.1) janë klasike. Në rastin konkret ne kemi $\gamma = 0$, $\delta = 0$, $a = 1/2C_{2p-1}$

Kështu, zbatohet Teorema e mësipërme dhe përftojmë këtë teoremë.

Teorema 1.3

Duke respektuar pranimet e mësipërme, problemi jo-linear i rastit i reaksion – difuzionit (1.33), (1.34), (1.35) ka zgjidhje stacionare të vetme.

KAPITULLI 2

Ekzisteca dhe uniciteti i zgjidhjeve për ekuacionet dy-dimensionale stokastike lineare të Boussineq.

2.1 Hyrje

Një rëndësi të vecantë në studimin tonë ka rrjedhja e ujit nëpër një akuifer të pakufizuar të tokës, që mund të modelohet nga ekuacioni Boussinesq. Ky ekuacion nxirret duke zbatuar parimin e ruajtjes së masës, ligjin Darcy dhe hipotezën Dupuit-Forchheimer (Bear, 1972). Ekuacioni dy-dimensional i Boussinesq ka formën:

$$\frac{\partial u}{\partial t} = \sum_{i=1}^{2} \frac{\partial}{\partial x_i}\left[\frac{k_i}{s}(u+d)\frac{\partial}{\partial x_i}(u+d)\right] + \frac{r-ET}{s}, \tag{2.1}$$

$(x,t) \in D \times (0,T]$,

ku $x = (x_1, x_2) \in D \subset R^2$ tregon koordinatat hapësinore (ndryshoret), t është koha e ndryshueshme, D tregon një zonë hapësinore të kufizuar me kufij të lëmuar ∂D, $T > 0$ është një konstante.

$$x = (x_1, x_2), \quad |x|^2 = x^2{}_1 + x^2{}_2, \quad dx = dx_1 * dx_2$$

$u = u(x,t)$ paraqet lartësinë e sipërfaqes së lirë mbi shtresën e papërshkueshme, d tregon thellësinë e akuiferit (matur nga shtresa e papërshkueshme), k_i tregon përcjellshmërinë hidraulike të ngopur të tokës, ET tregon evapotranspirimin, r tregon ringarkimin, s tregon porozitetin e kullueshëm.

Ekuacioni i Boussinesq (2.1) shoqërohet me kushtin fillestar:

$$u(x,0) = u_0(x), \quad x \in D, \tag{2.2}$$

dhe me kushtin kufitar Dirichlet

$$u(x,t) = H(x,t), \quad (x,t) \in \partial D \times (0,\mathrm{T}) \tag{2.3}$$

ku $u_0(x)$ dhe $H(x,t)$ më sipër janë funksione konkrete. Në mënyrë të ngjajshme, ne mund të konsiderojmë kushtin kufitar të Neumann.

$$\frac{\partial u(x,t)}{\partial u\,(x)} = H_1(x,t), \quad (x,t) \in \partial D \times (0,T]$$

Ekuacioni i linearizuar i Boussinesq është

$$\frac{\partial \mathrm{u}}{\partial \mathrm{t}} = \sum_{\mathrm{i}=1}^{2} \frac{\partial}{\partial \mathrm{x_i}} [\frac{\mathrm{k_i}}{\mathrm{s}} \mathrm{H_0} \frac{\partial}{\partial \mathrm{x_i}} (\mathrm{u} + \mathrm{d})] + \frac{\mathrm{r} - \mathrm{ET}}{\mathrm{s}}, \qquad (\mathrm{x}, \mathrm{t}) \in \mathrm{D} \times (0, \mathrm{T}] \tag{2.4}$$

ku H_0 (konstante) tregon thellësinë mesatare të akuiferit.

Në studimin tonë shqyrtohet ekuacioni i linearizuar stokastik Boussinesq:

$$\frac{\partial \mathrm{u}(\mathrm{x},\mathrm{t},\omega)}{\partial \mathrm{t}} = \sum_{\mathrm{i}=1}^{2} \frac{\partial}{\partial \mathrm{x_i}} [\frac{\mathrm{k_i}(\mathrm{x},\mathrm{t},\omega)}{\mathrm{s}(\mathrm{t},\omega)} \mathrm{H_0} \frac{\partial}{\partial \mathrm{x_i}} (\mathrm{u}(\mathrm{x},\mathrm{t},\omega) + \mathrm{d}(\mathrm{x},\omega)) + \frac{\mathrm{r}(\mathrm{x},\mathrm{t},\mathrm{u},\omega) - \mathrm{ET}(\mathrm{x},\mathrm{t},\mathrm{u},\omega)}{\mathrm{s}(\mathrm{t},\omega)}$$

$$(x,t,\omega) \in D \times (0,T] \times \Omega \tag{2.5}$$

ku $\Omega = \{\omega\}$ tregon hapësirën probabilitare të zgjedhjes dhe ω tregon ndryshoren e rastit.

Ekuacioni (2.5) shoqërohet me kushtin fillestar

$$\mathrm{u}(\mathrm{x},0,\omega) = \mathrm{u_0}(\mathrm{x},\omega) \quad , \quad (\mathrm{x},\omega) \in D \times \Omega \tag{2.6}$$

dhe me kushtin kufitar Dirichlet

$$\mathrm{u}(\mathrm{x},\mathrm{t},\omega) = \mathrm{H}(\mathrm{x},\mathrm{t},\omega) \quad , \quad (\mathrm{x},\mathrm{t},\omega) \in \partial D \times (0,T] \times \Omega \tag{2.7}$$

ku $\mathrm{u_0}(\mathrm{x},\omega)$ dhe $\mathrm{H}(\mathrm{x},\mathrm{t},\omega)$ janë përkatësisht funksion i rastit dhe fushë e rastit.

Në mënyrë të ngjashme mund të shqyrtohet kushti kufitar i von Neumann.

Pedologjia Moderne e konsideron tokën si një sistem dinamik kompleks, i cili evoluon nën ndikimin tërësor të ndërveprimeve midis faktorëve natyrorë dhe biologjikë, si dhe veprimtarisë njerëzore. Për shkak se këto ndërveprime janë procese të rastit, është e arsyeshme të supozohet se rrjedhja e ujit në tokë përshkruhet nga një fushë e rastit. Gabimet në matjen e përcjellshmërisë hidraulike, porozitetit të kullueshëm, ringarkimit dhe evapotranspirimit janë arsye të tjera për praninë e rastësisë në procesin e rrjedhës së ujit në tokë. Këto argumente kanë shumë mbështetës midis shkencëtarëve dhe fizikanëve të botës, të cilët vazhdojnë të tregojnë një interes më të madh për modelet stokastike të rrjedhës së ujit në tokë. Ata përdorin modelet stokastike në mënyrë efektive në punën e tyre kërkimore, shiko Freeze (1975), Cordova dhe Bras (1981), Chung dhe Austin (1987), Zhang (2002), P.Croisille (2005), Zhangxin Chen (2006), Yandita R. (2011), etj.

Të dhënat eksperimentale nga shumë vende, përfshirë Shqipërinë, mbështesin hipotezën se përcjellshmëria hidraulike e tokës së ngopur, poroziteti i kullueshëm, ringarkimi dhe avullimi janë variabla të rastit, shih Averjanov (1972), Van Schilfgaarde (1974-1979), Freeze (1975), Hubert (1976), Skaggs and Tang (1976), Sagar and Preller (1980), Cordova and Bras (1981), Kolaneci, Xinxo and Bica (1983), Chung and Austin (1987), Zhang (2002), P.Croisille (2005), Zhangxin Chen (2006), Yandita R. (2011), Sotir Tego (2019), etj. ([21], [22], [23], [24], [25], [26]).

Në varësi të mënyrës se si futet rastësia në rrjedhën e paqëndrueshme të ujit në tokë, ekzistojnë katër probleme matematikore, me një rritje të nivelit të kompleksitetit:

1. Problemi me kushtin fillestar të rastit.
2. Problemi me kushtin kufitar të rastit.
3. Problemi me rimbushjen e rastit ose evapotranspirimin e rastit.
4. Problemi me përçueshmërinë e rastësishme hidraulike ose porozitetin e kullueshëm të rastit.

Kapitulli është i organizuar si më poshtë. Në paragrafin 2.2 formulohet problemi (2.5), (2.6), (2.7) në një mjedis funksional të përshtatshëm. Në paragrafin 2.3 vërtetohet teorema e ekzistencës dhe unicitetit për problemin (2.5), (2.6), (2.7).

2.2 Hapësirat funksionale dhe formulimi i problemit

Le të jetë: (Ω, F, μ) ose (Ω, F, P) një hapësirë probabilitare, ku Ω = {ω} tregon hapësirën e ngjarjeve elementare (ose hapësirën e rezultateve themelore), F është σ-algjebra e shoqëruar me Ω, dhe μ (ose P) është masa probabilitare e përcaktuar. Algjebra σ e F mund të interpretohet si një koleksion i të gjitha ngjarjeve të rastit $\omega \in \Omega$ dhe që kanë një probabilitet të përcaktuar mirë në lidhje me F. Në studimin tonë do të përdoret teoria e Hapësirave Sobolev mbështetur në Adams (1975) dhe Tribel (1986).

Do të përdorim shënimin X=X(ω) për variablin rastësor me vlera reale: $X\colon \Omega -> R$.

Supozojmë se masa e probabilitare μ ka një bazë të numërueshme D$\subset R^2$ që tregon një zonë të kufizuar me kufij të lëmuar $\partial D,\ 0 < T < +\infty$

$$Q_T = D \times (0,T] \text{ and } S_T = \partial D \times (0,T]$$

Hapësira separabile (e ndashme) Hilbert $L^2(\Omega)$ është e mirënjohur. Shënimi

$$M= \{f(x,\omega): D \to L^2(\Omega)\}$$

tregon bashkësinë e funksioneve të rastit të rendit të dytë f(x,ω) mbi zonën D.
Përcaktohet hapësira

$$H= L^2(D; L^2(\Omega))= \{f= f(x,\omega) \in M\},$$

E paisur me normën

$$|| f ||_\Omega \in L^2(D)\},$$

dhe me produkt skalar

$$(f,g)_H = \int_D (f,g)_\Omega \, dx, \forall f,g \in H.$$

Norma e induktuar nga produkti skalar është:

$$|| f ||_H = \left(\int_D (|| f ||_\Omega^2 \, dx\right)^{1/2}, \forall f \in H.$$

Përkufizimet e hapësirave funksionale

$$C^\infty(D), \mathcal{L}(D), \mathfrak{D}^1\big(D; L^2(\Omega)\big), \ C^m\big(D; L^2(\Omega)\big), \text{ për } m \geq 0$$

$$C_c^m\big(D, L^2(\Omega)\big) \text{ dhe } H^m = H^m(D; L^2(\Omega)),$$

konsiderohen të njohura.
Për $f = f(x,\omega) \in M$ janë përkufizuar derivatet e përgjithësuar të rendit α
në lidhje me x:

$$D^\alpha f(\varphi)=(-1)^{|\alpha|} \int_D f \, D^\alpha \varphi dx, \ \varphi \in \mathfrak{D}(D), \ \alpha= (\alpha_1, \alpha_2), |\alpha|=\alpha_1+ \alpha_2).$$

Në qoftë se $f \in H^m = H^m(D; L^2(\Omega))$, gjurma e f në ∂D përcaktohet si

$$\gamma^{(m)}(f) = \{f, \frac{\partial f}{\partial}, \ldots, \frac{\partial^{m-1} f}{\partial^{m-1}}\}, \ m=2,3,4,\ldots$$

Eshtë e qartë që $\gamma^{(m)}(f) \in \big(L^2(D); L^2(\Omega)\big)^m$, ku ana e djathtë tregon produktin kartezian.
Shqyrtohet hapësira e mëposhtme

$$H_0^m = H_0^m\big(D, L^2(\Omega)\big)= \{f \in H^m, \gamma^{(m)}(f) = 0\}$$

H_0^m është një hapësirë e mbyllur e H^m.
